



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:074178

Datë: 30.04.2021

Numri i dokumentit: 01753047

P.nr.1022/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Sabit Sadikaj, në çështjen penale kundër të pandehurit F.M., për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314, par.6 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës me Kërkesë për Shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1421/2021, të datës 19.04.2021, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës, me datë 27.04.2021, mori:

A K T G J Y K I M

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1421/2021, të datës 19.04.2021, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

F.M., nga i ati I. dhe nëna S., i lindur me datën ... nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës, i martuar, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 09.12.2020, në shtëpinë e tij në fshatin ..., Komuna e Fushë Kosovës, me qëllim që vetit ti sjell përfitim të kundërligjshëm ka vjedhur dhe shfrytëzuar energjinë elektrike pa autorizim të KEDS-it, si furnizues i autorizuar, në atë mënyrë që ditën e incidentit, gjatë kontrollit të kryer nga personat e autorizuar nga KEDS-i, të njëjtit kanë konstatuar se i pandehuri është kyçur direkt jashtë pikës matëse me një kabëll nga shtylla elektrike në shtëpinë e tij, ku energjia e shpenzuar nuk është matur fare, me c'rast të dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm financiar në shumën prej 252.81 Euro

- me këtë ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314, par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve 4; 7; 17; 21; 41; 43; 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **njëqind e pesëdhjetë euro (150.00€)**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar, i pandehuri mund ta paguaj deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) muaj nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo njëzet euro 20.00 € me një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzet euro (20.00€), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar KEDS, për realizimin e demit udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1421/21, të datës 19.04.2021, ka akuzuar F.M., për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.6 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar e që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjyqtari i çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës të tilla si: Procesverbali nr.0736980, i datës 15.03.2021, fatura e KEDS mbi kalkulimin e humbjeve e dt.09.03.2021, Foto dokumentacioni, si dhe shkresat që i janë bashkangjitur lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 par. dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm-
P.nr.1022/21, të dt.27.04.2021

Numri i lëndës: 2021:074178
Datë: 30.04.2021
Numri i dokumentit: 01753047

Gjyqtari,
Sabit Sadikaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi - urdhri ndëshkimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimet të njëjtit, në këtë gjykatë.